

**SUPREME COURT OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL**  
**KOLEGJI I APELIT TË AKP-së**  
**ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-210/13

Prishtinë/Priština,  
22 Prill 2015

Në çështjen juridike të:

**D.B.**

Obilić

**Pala ankuese**

kundër.

**M. S.**

Obiliq

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Esmë Erterzi dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/191/2013 të datës 13 shkurt 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA01206), pas shqyrtimit të mbajtur më 22 Prill 2015, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e D. B. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/191/2013 të datës 13 shkurt 2013 për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA01206.
2. Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/191/2013 të datës 13 shkurt 2013 për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA01206.
3. Hedhet poshtë kërkesa e D. B. për të drejtën e shfrytëzimit mbi banesën në pronësi shoqërore për shkak të mungesës së juridiksionit të KKPK-së.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 9 Nëntor 2007, D. B. (në tekstin e mëtejshëm: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku ka kërkuar vërtetimin e së drejtës së tij për shfrytëzimin e një banese me sipërfaqe prej 82.35 m<sup>2</sup> që gjendet në rrugën “Milos Obiliq” Lam D në Obiliq (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar). Posedimin ndaj pronës së kërkuar e kishte humbur më 1 qershor 1999 si rezultat i rrethanave të viteve 1998/1999 në Kosovë. Ai ka kërkuar vërtetimin e pronësisë dhe kthimin e pronës në posedim.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar në AKP dokumentet e mëposhtme:
  - Aktvendimin Nr.456/98-5, për formimin e komisionit për ndarjen e banesave, të lëshuar nga Ndërmarrja Publike “Elektroprivreda Serbije” me datën 17 dhjetor 1998.
  - Vendimin Nr.1834, për ndarje të banesës, të lëshuar nga Ndërmarrja Publike “Termoelektrana Kosova” me datën 25 dhjetor 1998 përmes të cilit, D.B. i ndahet për shfrytëzim (në bazë të qirasë me kohë të pacaktuar), banesa që gjendet ne Obiliq, Lamela D, me sipërfaqe prej 82.35m<sup>2</sup>.

- Kontrata për shfrytëzimin e banesës përmes qirasë Nr.1834-1, lëshuar nga Ndërmarrja Publike “Termoelektrana Kosova” me datën 28 dhjetor 1998. Kontrata ishte lidhur mes “Termoelektrana Kosova” dhe D. B. për kohë të pacaktuar.
3. Më 15 janar 2008, AKP-ja ka bërë identifikim e pronës duke e vendosur një shenjë në vendin ku supozohej që gjendej banesa e cila doli të jetë në posedim të M. S. (në tekstin e mëtutjeshëm: Pala përgjegjëse në kërkesë). Pala përgjegjëse në kërkesë merr pjesë në procedurën para AKP-së, duke pretenduar se banesa në fjalë iu ishte ndarë nga ana e Kuvendit Komunal të Obiliqit në vitin 2005.
  4. Për të mbështetur pretendimin e saj ajo ka dorëzuar në AKP :
  5. Vendimin Nr.01-42/05, të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Obiliqit me datën 16 mars 2005 në bazë të cilit M. S. i ndahet banesa me qira për 10 vite në objektin “D” me sipërfaqe prej 82.35m<sup>2</sup>.
  6. Sipas raportit të verifikimit të AKP-së të datës 15 nëntor 2012, dokumentet të cilat paraqitësi i kërkesës i prezantoi në mbështetje të kërkesës nuk kanë mundur të verifikohet.
  7. Më 13 shkurt 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës me vendimin KPCC/D/R/191/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA01206) ka refuzuar kërkesën. Në paragrafin 46 dhe 47 të vendimit grupor, i cili sipas vendimit të vërtetuar të datës 13 shkurt 2013 zbatohet veçanërisht për kërkesën në fjalë, theksohet se dokumentet që ka dorëzuar paraqitësi i kërkesës, nuk janë verifikuar nga ana e Sekretarisë Ekzekutive. Sekretaria Ekzekutive po ashtu nuk ka mundur të sigurojë *ex officio* dëshmi që do të mbështetnin kërkesën e paraqitësit të kërkesës. Në mungesë të dëshmive të mjaftueshme në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën pronësore për pronën e kërkuar. Rrjedhimisht kërkesa refuzohet.
  8. Vendimi i është dorëzuar D.B.më 19 qershor 2013. D. B. (në tekstin e mëtutjeshëm : Pala Ankuese ) paraqiti ankesë më 18 korrik 2013. I njëjti vendim i është dorëzuar M. S. ( në tekstin e mëtejshëm: pala përgjegjëse në ankesë ) me datën 19 qershor 2013.
  9. Gjykata Supreme ka pranuar lëndën më 17 tetor 2013.

**Pretendimet e palëve:**

10. Pala Ankuese thekson se vendimi i KKPK-së përmban shkelje esenciale dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale dhe asaj procedurale pasi atë iu ka pamundësuar ri-posedimi banesën dhe në këtë mënyrë edhe mundësia e blerjes së banesës të cilën e kishte fituar në bazë të vendimeve të bashkangjitura në ankesë.
11. Sipas Palës Ankuese, arsyetimi se Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur ti verifikojë në institucionet kompetente dokumentet e paraqitura nga ai nuk qëndron, pasi që, Sekretariat Ekzekutive ka mundur të mbajë seancë dëgjimore ku do të merrte pjesë pala ankuese dhe do të konstatohej se banesën kontestuese e kishte fituar në mënyrë ligjore në bazë të dokumenteve tanimë të prezantuara.
12. Ankesa i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë me datën 30 tetor 2013. Ajo nuk është përgjigjur në ankesë.

**Arsyetim ligjor:***Pranueshmëria e ankesës*

13. Ankesa është dorëzuar brenda afatit 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme.

*Meritat e ankesës*

14. Kërkesa ka të bëjë me dhënien në qira të banesës të Ndërmarrjes Publike “Termoelektrana Kosova” .
15. Në pajtueshmëri me nenin 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë që t’i zgjidhë kërkesat që kanë të bëjnë me të drejtën e pronësisë në pronën private dhe kërkesat që kanë të bëjnë me të drejtën e shfrytëzimit për sa i përket pronës private të paluajtshme. Prandaj, për Gjykatën Supreme është e nevojshme që të përcaktojë nëse prona e Ndërmarrjes Publike “Termoelektrana Kosova” është pronë private.

16. Sipas nenit 2.1 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, këtej e tutje Urdhëresa Administrative (UA) “çdo person i cili ka pasur të drejtë të pronësisë, posedim ligjor apo çfarëdo të drejte tjetër ligjore të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme private, i cili në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj pronësore për shkak të rrethanave që janë të ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur të viteve 1998/1999 ka të drejtë rikthimi të së drejtës pronësore, si bartës i së drejtës pronësore”.
17. Banesa në fjalë asnjëherë nuk ka qenë pronë e paluajtshme private dhe në këtë mënyrë është jashtë fushëveprimit të zbatimit të procedurave pranë AKP-së.
18. Nuk është e kontestueshme se banesa ishte në pronësi të Ndërmarrjes Publike “Termoelektrana Kosova” d m th. ishte në pronësi shoqërore. Sipas nenit 321, paragrafi 1 të LPK, nuk ka nevojë të provohen faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e mëhershme.
19. Nuk ka argument nëse kjo banesë i ishte dhënë në shfrytëzimi palës ankuese në vitin 1998 pasi që dokumentet të cilat ai i ka paraqitur para AKP-së nuk ishin verifikuar pozitivisht. Megjithatë, kjo nuk është relevante.
20. Vërtetimi dhe mbrojtja e të drejtave të shfrytëzimit ndaj pronave shoqërore dhe/apo shtetërore nuk është në juridiksion të KKPK-së, respektivisht të Kolegjit të Apelit të AKP-së.
21. Ndonëse objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit ishin pretendimet e palës ankuese se ai e ka fituar të drejtën e shfrytëzimit mbi bazën e kontratës së shfrytëzimit përmes qirasë Nr.1834-1, gjykata gjeti se ekipi i verifikues ka konstatuar se një kontratë e tillë nuk është verifikuar pozitivisht .
22. Prandaj banesa kontestuese edhe me tej udhëhiqet si pronë shoqërore gjë që sipas dispozitës 3.1 (b) të ligjit Nr. 03/L-079, nuk është në kuadër të kompetencës së KKPK-së rrjedhimisht të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme.
23. Bazuar në të mësipërmen dhe në pajtueshmëri me nenin 12.2 të Ligjit Nr. 03/L-079 dhe nenit 198.1 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë juridike:**

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Esma Erterzi , Gjyqtare e EULEX-it**

**Rolandus Bruin , Gjyqtar i EULEX-it**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**